

VENDIM
Nr. 629, datë 27.10.2021

**PËR KALIMIN NË PRONËSI NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE BASHKIA
GRAMSH, TË PRONËS NR. 1439, ME EMËRTIM “ISH-REPART USHTARAK”, ME
VENDNDODHJE NË ÇEKREZ, FSHATI KOÇAJ, GRAMSH, DHE PËR NJË
NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË
PALUAJTSHME SHETETËRORE, TË CILAT I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI
ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në pronësi, nga Ministria e Mbrojtjes te Bashkia Gramsh, të pronës nr. 1439, me emërtim “Ish-repart ushtarak”, me vendndodhje në Çekrez, fshati Koçaj, Gramsh, sipas plan-rilevimit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për ta përdorur për ndërtimin e varrezave të reja të qytetit Gramsh.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes”, të ndryshuar, të hiqet prona nr. 1439, me emërtim “Ish-repart ushtarak”, me vendndodhje në Çekrez, fshati Koçaj, Gramsh, sipas plan-rilevimit, dhe të shtohet në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kanë kaluar në pronësi ose në përdorim Bashkisë Gramsh, miratuar me vendimin nr. 431, datë 11.7.2007, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Gramsh, të qarkut të Elbasanit”, të ndryshuar.

3. Bashkisë Gramsh i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t’ua japë atë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, kryetari i Bashkisë Gramsh dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE
Prona nr.1439 "Ish Rep. Ush" Çekrez, Koçaj, Gramsh

PRONARI SHTET (Komanda Mbështetëse) DATË 08/04/2021 QËLLIMI TRANSEFERIM

VENDNDODHJA

Bashkia GRAMSH ZVASHK GRAMSH Nr.Pasurisë 298,299,300,301,302 Z.K2167 Indeksi i Hartës K-34-113-(119-A)


TE DHËNAT E PASURISË

Lloji i pasurisë _____ Sip e pasurisë **10 900m²** Sip e gjurmës së ndërtimit **503m²** Nr. kateve _____ Nr. pemeve _____

Nord = 4523749.64
East = 515927.87

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE (KRGJSH)

Nord = 4523749.64
East = 516367.78



Nord = 4523398.57
East = 515927.87

SH 1: 2500

Nord = 4523398.57
East = 516367.78

NR	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI I KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT
1	Ven			109, 295	K51726024H
2	Lindje				
3	Jug			366	
4	Perëndim			368	

REALIZOI PËR IGJIU
Specialist Ramiz Haxhiu

KONFIRMOI PËR IGJIU
DREJTORI Ark. Enea SINOIMERI

REALIZOI PËR ASHK
Specialisti
DVASHK
Nënshkrimi
KONFIRMOI
Përgjegjësi/Drejtori
Nënshkrimi/ Vula

TEKNOLOGJIA E MATJEVE Z-Zyrë; O-Ortofoto;

PËRCAKTIMI I KUFIRIT: Sipas dokumentacionit hartografik marrë në arkivin e IGJIU Harta Kadastrale

SHËNIME TË VEÇANTA: Ky planrilevim u hartua në zbatim të shkresës së Komandës Mbështetëse nr.1396/2, datë 10.03.2021, bazuar në dokumentacionin hartografik marrë në arkivin e IGJIU-së.

PRONARI Komanda Mbështetëse

MIRATOHET
ZV/KOMANDANT I KOMANDES MBËSHTETËSE
Kolonel Përparim GEGA